



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/236

Datë: 28.06.2018

Procesverbal

i mbledhjes se I (e parë) të jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale, për vitin 2017 (Janar-Dhjetor 2017).
3. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2018.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/525 datë:12.04.2018 dhe marrja e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, të hapësirave publike për vendosjen e reklamave në qytezën e Malishevës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/594 datë:20.04.2018 për shqyrtimin e draft-Planit të Integritetit të Komunës së Malishevës për vitet 2018-2020.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/598 datë: 23.04.2018, për marrjen e vendimit në lidhje me miratimin e draft-dokumentit, Plani i veprimit për Transparencë në Komunën e Malishevës për vitin 2018.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/38 datë:25.04.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për bartjen e mjeteve (THV) nga viti fiskal 2016 dhe 2017 në vitin fiskal 2018.
8. Shqyrtimi dhe miratimi përfundimtar i projekt-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2018.
9. Debat mbi çështjet e barazisë gjinore në Institucionet publike të Komunës së Malishevës.
10. Shqyrtimi i zbatimit të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore nga Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë.
11. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/125 datë:27.04.2018 e parashtruar nga banorët e lagjes "Hoti" në Malishevë për ndarjen e mjeteve për rregullimin e varrezave.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Planit të veprimit të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për periudhën Maj-Dhjetor 2018.
13. Emërimi i anëtarit nga zyra e Kryetarit të Komunës në Komisionin Komunal të Aksionarëve.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2019-2021.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/727 datë:18.05.2018 për dhënien në shfrytëzim të pronës publike në fshatin Terpezë, KK.Malishevë për qëllime të infrastrukturës energjetike.
16. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/178 datë: 08.06.2018 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit Komunal për iniciimin e procedurave për miratimin e draft-Rregullores për Token bujqësore në Komunën e Malishevës.
17. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/186 datë:12.06.2018 të parashtruar nga shefi i Grupit të anëtareve të KK-së të Lëvizjes Vetëvendosje.
18. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/156 datë: 22.05.2018 të Kryesuesit të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural.
19. Shqyrtimi i kërkesës nr.08/163 datë: 23.05.2018 të 32 të parashtruar nga Cen Desku, për 32 familjet e Lagjes Mirditë në Malishevë.
20. Shqyrtimi i kërkesave.

21. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 19.06.2018, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, rendin e ditës e keni me material, janë edhe disa kërkesa. Kërkesa e fshatit Bubavec për me hjekë një pëlqim për një kompani për përpunimin e gurit, kërkesën e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës për KEDS në fshatin Terpezë, si dhe kërkesa për plotësim të tre emrave të KKSB, po ashtu edhe Plani i punës i KKSB për 2018, rendin e ditës e keni marrë a ka dikush diçka.

Alban Krasniqi: Unë e kam paraqitur një kërkesë për Kuvendin që DKA gjatë zgjedhjes së drejtorëve që këta ta paraqesin planin 4 vjeçar para publikut.

Rrahim Morina: Kërkesa nr.01/186 datë: 12.06.2018 si dhe disa pika në plan të punës që janë, si dhe të futet Informatë nga drejtorja e Bujqësisë rreth përgatitjeve për korrje-shirjet 2018.

Hashim Vrenezi: Në këtë mbledhje nuk e kemi pranuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar pikat tjera i kemi këtë e kam si shqetësim me mirë me shty mbasi s'është procesverbal.

Rrahim Morina: Nuk po e arsyetoj askënd por procesverbalin kam mendu se paku tani ta kemi në mbledhje por për shkak se kemi pas disa mbledhje dhe nuk ka mundur të përgatitet, mbledhjen që vjen do të përgatitet, nëse doni e shtyjme mbledhjen por spo e shoh të arsyeshme me shty pse s'është procesverbal.

Alban Krasniqi: Procesverbal s'është çështje jetike me shty një mbledhje, por ne jemi marr vesh që në secilën mbledhje të KPF te futen pikat që kanë mbet, ato që janë në plan të punës, dhe ato që na vijnë.

Hashim Vrenezi: Ndoshta ka kërkesë që bëhet pas thirrjes së mbledhjes e nuk vijnë në mbledhje, e ka që behën me herët dhe nuk na sillen.

Raimonda Krasniqi: Edhe unë jam që mbledhja të shtyhet, dhe të mbahet nesër në ora 11, sepse jemi duke i mbyllur notat.

Rrahim Morina: Unë prej gjitha drejtorive kam kërkuar që pikat që i kanë me plan të punës t'i sjellin para datës së thirrjes se mbledhjes.

Hashim Vrenezi: Të pika e Bujqësisë ka probleme pasi që ka raste që qytetaret nuk mbjellin, e kur shkon dikush me aplikuar e gjen aty ne tik të bërë nga dikush tjetër dhe i thonë ta ka zënë atë are dikush tjetër e ndoshta arën e ka mbjell vet, ta fusim si pikë dhe të debatohet.

Alban Krasniqi: Drejtorja e Bujqësisë të sjellë raport pra të precizohet përgatitjet për korrje-shirjet.

Valon Krasniqi: Është mirë që ta kemi edhe listën e përfituesve për multikultivator.

Rrahim Morina: Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës publike thotë që Kryetari i Komunës duhet të jep arsyetimin për pronën, pastaj të shkoj në Kuvend.

Hashim Vrenezi: Për pikat që nuk janë të përgatitura me material pse me humb kohë në Kuvend.

Alban Krasniqi: Mirë është që anëtarët e Kuvendit të kenë Statutin e Komunës, rregulloren e punës së Kuvendit dhe të kemi ID kartela.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo mbledhje të shtyhet për nesër dhe të futen në rend dite pika që kanë hy në Kuvend por që s'janë shqyrtuar.

Unanimisht ishin për shtyrje.

Mbledhja vazhdoj më datë: 20.06.2018, në ora 11 morën pjesë 5 anëtar të Kpf, zyra për informim.

Rrahim Morina: Për raportin e Bujqësisë dje kam pyetur në drejtorinë për Bujqësi me thanë drejtori s'është këtu, shtabin për korrje shirje ende se kanë formuar dhe kjo pikë ende s'është gati. Edhe sa i përket raportit të Kryetarit të Komunës në Statut ceket që raporti duhet të miratohet dhe në rend dite mund ta bëjmë miratim.

Raimonda Krasniqi: T'i zvogëlojmë pikat në rend dite, sepse shumë pika po kemi.

Rrahim Morina: Mos prezenca e qeverisë komunale i ka grumbulluar pikat kaq shumë, por kjo mund të rregullohet në nivel të shefave.

Alban Krasniqi: Shqyrtimi i procesverbalit shtyhet në mungesë të materialit, kurse raporti i Kryetarit të Komunës hartohet pa u bazuar në praktikë të Institucionit. Raportet që institucionet raportojnë në Kuvend të Kosovës ka formate të raportimit në dy aspekte, Planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve e në fund shkruhen rekomandimet dhe sfidat. Këtu shihet që secila drejtori ka metodë të vetën e që nuk komunikon ndoshta me ndonjë drejtori tjetër shihet që raportit i mungon standardizimi. Në Bujqësi cilat janë masat që janë marrë nëse ka pas dëme, sa ka qenë buxheti për Bujqësi, për 139 mijë euro ka me pak se një faqe e që një organizatë jo qeveritare që i jepen fonde i kërkohet të ketë raport dhe bën një raport me të mirë. Ky raport nuk është i

kompletuar dhe në kot japim vërejtje se edhe herën tjetër nuk përmirësohet, duhet që formati i raportit të standardizohet.

Rahim Morina: Kush jeni që raporti i qeverisë Komonale janar-dhjetor të rekomandohet për kuvend? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2018.

Alban Krasniqi: Në raport ka drejtori me gjysmë faqe e ka drejtori me 5 fletë të aktiviteteve, ne bëjmë shkelje nëse qojmë një pikë në Kuvend kur kemi paqartësi e në mbledhje s'është as kryetari, as nënkryetari dhe as drejtori kompetent.

Raimonda Krasniqi: Ne duhet t'i ndëshkojmë nëse qeveria komunale nuk përgjigjen.

Rahim Morina: Ne mund të kërkojmë veprimet e ekzekutivit në raport me Kuvendin.

Hashim Vrenezi: Te pika dhënia në shfrytëzim për reklamën këtyre ju konvenon me bojkotuar, sepse këta po i shfrytëzojnë ato.

Alban Krasniqi: Proceduralisht si kryesues dërgoja një letër Ministrisë për mungesën e Kryetarit, nënkryetarit, të drejtorëve në KpF, dhe si me diskutuar me mungesën e tyre.

Rahim Morina: A pajtoheni që të gjitha ato pika që janë hy në kuvend e që sot i kemi për trajtim t'i rekomandojmë për Kuvend, pika: 2-12? Unanimisht ishin për.

Pika 13. Emërimi i anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Rahim Morina: Nëse Kryetari se sjell emrin e anëtarit në Komision le të tregojë ne veprimet me tutje.

Alban Krasniqi: Për këtë pikë Kuvendi ka vendosë, Kryetari se ka sjellë emrin nëse ai se sjellë kërkoj formalisht të na ftosh ne dy anëtarëve tjerë pra proceduralisht, sepse shumica është me dy anëtarët tjerë.

Rahim Morina: A jeni kjo pikë të rekomandohet për kuvend? Unanimisht ishin për.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Kornizës afatmesme buxhetore të Komunës së Malishevës 2019-2021.

Alban Krasniqi: Sipas librit të proceseve për menaxhimin e shpenzimeve publike nga Ministria e Financave tregojnë qartë për secilin proces prej prokurimit dhe si shkon KAB, e që këtu po shkruan që qeverisje lokale e ka krye procesin faqe 3. Në total të aktiviteteve parapërgatitja e buxhetit të Komunave sipas Ligjit për Financat publike thotë që për KAB Kryetarit i dërgohet për aprovim, pastaj dërgohet në KpF, nëse jo kthehet për shqyrtim në dy komitetet, dhe ceket nëse ka vërejtje shqyrtohet në KpF, pastaj shkon në kuvend. Propozoj t'i kthehet kur do që vepron sipas Ligjit dhe t'i bëhet një shkresë Kryetarit të paraqet në mbledhje të KpF KAB-in.

Rahim Morina: Nga drejtori i financave kam kërkuar me ardhë në mbledhje ai me ka thënë se nëse kryetari me thotë vi në mbledhje nëse jo nuk vi, data 30 qershor është fundi që Kuvendi duhet me miratuar.

Hashim Vrenezi: E mbështes Albanin me shty këtë pikë, sepse proceset po neglizhohen dhe duhet me fillu me kushtëzime, sepse aty ku po e pengojmë punët po shkojnë mirë.

Alban Krasniqi: Zyra për informim është mirë me publikuar që KpF me vërejtje e kthen KAB-in mbrapa.

Rahim Morina: Pas këtij diskutimi kush jeni që t'i kthehet Kryetarit për shqyrtim KAB.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/727 datë:18.05.2018 për dhënien në shfrytëzim të pronës publike në fshatin Terpezë, KK.Malishevë për qëllime të infrastrukturës energjetike.

Rahim Morina: Unë po ju lexoj Ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, dhënia në shfrytëzim për raste të veçanta, por nëni 7 paragrafi 1.2.3. thotë Kryetari i propozon Kuvendit për dhënien në shfrytëzim dhe duhet te paraqet një arsyetim, unë jam me kthi këtë kërkesë të kryetari për plotësim të dokumenteve.

Hashim Vrenezi: Afatin për dhënien në shfrytëzim nuk e kemi si dhe ku ka mu vendos ajo trafo e rrymës, se dimë a e pengon dikë atje a ka ndonjë shtëpi afër.

Raimonda Krasniqi: Në kërkesë Kryetari ka mujt me cek sepse disa shtylla i kemi ndërruar me para tonat, pastaj kryesia e fshatit s'është njoftuar hiq për këtë kërkesë është e pa qarte kërkesa, unë e njoh me pellemb atë pjesë por ku ka mu vendosë trafo spo e di, këtë kërkesë e kanë nënshkruar të nënshtruarit e Ragip Begaj.

Alban Krasniqi: Për dy çështje proceduralisht sa kompletuar, justifikimi dhe a ka drejtë Kryetari me dhanë tokë një institucionit privat, sepse ajo si aset i regjistrohet KEDS-it, sepse edhe ja rritë vlerën atij, po du me ditë si pronë qysh trajtohet.

Rahim Morina: Këtu ka kërkuar veç meja dhanë në shfrytëzim për kohën mundet dhe afatshkurtër meja dhanë.

Alban Krasniqi: Të dihet vendi ku po kërkohet me dhanë, sa shtëpi mund të furnizohen prej asaj trafo.

Rahim Morina: Të kthehet si kërkesë për zbatim të procedurave sipas nenit 7 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronës publike? Unanimisht ishin për te kthehet kërkesa.

16. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/178 datë: 08.06.2018 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit Komunal për inicimin e procedurave për miratimin e draft-Rregullores për Token bujqësore në Komunën e Malishevës.

Alban Krasniqi: Bazuar në vështirësitë si anëtar të Kuvendit se para çdo vendimmarrje që kemi pas kanë munguar dokumente dhe opinione, ka pas fryme mirëkuptimi të hartohet një draft-rregullore për ndërrimin e destinimit të tokës. Një grup ekspertesh në Lëvizjen Vetëvendosje kanë hartuar një draft bazuar në ligjin për tokën bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ të Unmikut. Të rregullohet kjo sferë e më këtë rregullore ngushtohet hapësira e vendimmarrjes.

Rahim Morina: Mbase u dhanë sqarimet kush jeni ta rekomandojmë për kuvend ?

Unanimisht ishin për rekomandim për kuvend.

17. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/186 datë:12.06.2018 të parashtruar nga shefi i Grupit të anëtareve të KK-së të Lëvizjes Vetëvendosje.

Alban Krasniqi: Ne me datën 12 të këtij muaji ju kemi drejtuar kuvendit me këtë kërkesë dhe kemi kërkuar nga drejtoria e Arsimit e qëllimi ka dy elemente; rritë transparencën dhe llogaridhënien. Kemi pa që Dka ka shpall konkurs për drejtor të shkollave dhe a bërë mire se deri me tani disa kanë qenë ushtrues detyre, ka presion të jashtëzakonshëm se kush duhet me kanë drejtor, e ata shërbejnë si magnet i ndikimit në zgjedhje e në mbarëvajtje të punëve gjendja është shumë keq. Ne nuk kemi kërkuar ndërhyrje në aspektin e zgjedhjes por si monitorim, drejtori i një shkolle është personi kyç për atë fshat dhe shkollën e tij dhe të merr miratim nga ai komunitet . Kjo qe kemi kërkuar nuk ka pengesë ligjore, por të merret vendim të detyrohet DKA që kur të behët lista e ngushtë, me prezentu planet zhvillimore të shkollave, nëse ata s'janë në gjendje me ba një plan të tërhiqen, publikimi i rezultateve të jetë ne tabelë dhe paku të behtë presion moral dhe publik.

Raimonda Krasniqi: Është edhe udhëzimi administrativ i riu, por është vështirë se posti i drejtorit të shkollës është i pa definuar ende duhet të jetë ose post profesional ose politik, pastaj duhet të kërkohet që intervistimi të behet neper shkolle, sepse ndikon sado pak. Udhëheqës me te dobët si në këtë 4 vjeçar që lame pas ske pas kurrë dhe duhet gjërat të reflektojnë ndryshe. Ne kemi ndjek trajnimin e menaxhimit të shkollave për dy vite e kryetari i ka ftuar kanë ka dashtë i ka dërguar në atë kurs.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

18. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/156 datë: 22.05.2018 të Kryesuesit të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural.

Alban Krasniqi: Ne po rekomandojmë diçka që drejtori i Bujqësisë e ka pas obligim

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Valon Krasniqi: Kam degju që njerëzit që kanë me i marrë multikultivatorët e dinë enda pa i ndarë.

19. Shqyrtimi i kërkesës nr.08/163 datë: 23.05.2018 të 32 të parashtruar nga Cen Desku, për 32 familjet e Lagjes Mirditë në Malishevë.

Rahim Morina: Një komision ka qenë ne të kaluarën tash ndoshta mirë është një komisioni me formuar mu marrë me këtë kërkesë.

Alban Krasniqi: Çështjen e di qysh kur kam punuar si përkthyes kur këtyre ju kanë djeg banesat kanë hyrë në prona shoqërore ashtu qysh ka raste edhe në Prishrinë, këtyre duhet tu gjendet zgjidhja për banesë por jo për toka. Të themelohet një komision e mësuesi Cen të jetë në komision, një zyrtar ose drejtor dhe kjo punë të ecë përpara, se për ata s'është e lehtë.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

20. Shqyrtimi i kërkesave.

Një kërkesë e kemi për plotësim me 3 anëtar të KKSB, si dhe kanë kërkuar ta miratojnë Planin e punës për vitin 2018. Kush jeni për t'i rekomandojmë për kuvend

Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për

-Kërkesa për ndërrim destinimi për z. Qazim Bytyqi nga fshati Shkozë.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë pikë për Kuvend? Unanimisht ishin për

- Kërkesa nr.02/174 e datës: 01.06.2018 e parashtruar nga Haki Buçaj nga fshati Lladroc.

Rahim Morina: Unanimisht kjo kërkesë i kthehet kryetarit të Komunës për shqyrtim

- Kërkesa nr.02/179 datë:11.06.2018 e parashtruar nga Kryesia e fshatit Bubavec.

Alban Krasniqi: Kjo është kriminale qysh ka mujt mu mbajt debati në shkollën e fshatit Damanek e kur kjo kompani operon në Kijevë.

Hashim Vrenezi: Ky pëlqim është dhënë nga Kryetari e kompania i ka plotësuar kushtet ka edhe dokumentet dhe ka licencë të punës, këtu më shumë ka konotacion politik se ai i plotëson kushtet. Jam mos me fut si pikë në kuvend sepse kjo kompani është larg zonës së banuar dhe se pengon askënd.

Alban Krasniqi: Kjo duhet bërë praktikë që inspektorati me shku mi ndjek gjithë ata që punojnë pa te drejtë, sepse debati është parakusht me marr ai licencën, parimisht të gjithë i kisha mshelë se e hëngrën krejt.

Hashim Vrenezi: Ajo kompani veç e përpunon gurin e ka të ndaluar edhe me pyllzu aty, por që ka afat deri në vitin 2022, por këtu ka motiv politik nga disa njerëz.

Raimonda Krasniqi: Në kërkesë e kanë shkruaj se i ka kaluar afati por këtu ceket se ka afat të licencës.

Rrahim Morina: Me se shumti me brengos së e shoh qe edhe në Astrazup çfarë dëme na kanë bërë gurthyesit, e jam që çdo kush të punoj me kritere. Është mirë me kanë një komision me shku me pa se a e pengojnë këta gurëthyes dikë.

Alban Krasniqi: Duhet kjo punë mu debatit dhe me pa se apo i dëmtojnë qytetaret .

Hashim Vrenezi: Ne jemi mi mbrojt qytetarët nëse ndonjë kompani operon dhe i pengon, por më mirë është t'i rekomandohet Kryetari që ai të përgatit një raport për kuvend.

Valon Krasniqi: Ata qytetarë janë ankuar se aty atë guri e konsiderojnë si aset të fshatit.

Hashim Vrenezi: Kryetari asaj kompanie i ka dhënë pëlqim por tani të bëjnë një raport në kuvend e jo dukuritë e përgjithshme t'i shohim e t'i trajtojmë si të veçanta.

Rrahim Morina: Një kërkesë t'i bëhet kryetarit për të përgatitur një raport, por ne e rekomandojmë për kuvend, sepse janë kërkesa të qytetarëve.

Unanimisht ishin për që te rekomandohet për Kuvend, por edhe kryetari të paraqet raport për Kuvend.

- kërkesa nr. 02/212 e datës: 20.06.2018 e parashtruar nga zj.Besa H. Krasniqi nga fshati Terpezë.

Raimoda Krasniqi: Unë njoh këtë që ka bërë kërkesë për të e nevojshme është të gjejë ndoshta punë me punu edhe pse është e sëmurë, mirë është ne si komiteti ta ndihmojmë pasi për momentin ajo gjendet edhe në spital.

Valon Krasniqi: Kjo ka kërkuar me punu e ne duhet të krenohemi, por jam që ne t'i ndihmojmë.


Alban Krasniqi: Kërkesa ska protokoll është mirë kërkesat të jenë te kompletuar të kenë edhe ndonjë raport mjekësor me kanë bindes herave tjera.

Raimonda Krasniqi: E ka një vajzë, një motër, prindërit, por gjendjen shëndetësore se ka mirë, por unë do bëj përpjekje tju sjelli edhe raportin mjekësor.

Rrahim Morina: Kush jeni që këtë kërkesë ta miratojmë t'i ndajmë 250 euro? Unanimisht ishin për

Mbledhja përfundoi ne ora 13.50 min.

Procesmbajtësi
Naim Avdijaj Jur. i Dip.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

